

ROLI I KISHËS ORTODOKSE SERBE NË DËM TË ÇËSHTJES SË KOSOVËS (1912-1999)

Këtu trajtohet ekstremizmi ortodoks serb ndaj shqiptarëve, të motivuar nga kisha, si dhe shpërnguljet e dhunshme të shqiptarëve. Po ashtu, trajtohet edhe roli përgjegjës i kësaj kisha në gjenocidin ndaj myslimanëve të Ballkanit. Ajo ishte bashkëpjesëmarrëse në hartimin e shumicës së 32 programeve serbe për gjenocid ndaj shqiptarëve. Kontributi i saj në nxitjen e fashizmit serb është shumë i madh gjatë tërë historisë, sidomos gjatë luftërave të fundit në Ballkan, ajo ishte motivuese dhe bekuese i krimineleve serbë.

Gjate këtij punimi kam paraqitur disa hipoteza dhe disa pyetje lidhur me këtë hulumtim:

- Hipoteza 1. Kisha ortodokse serbe (KOS) pati rol mjaft destruktiv ndaj çështjes së Kosovës dhe ajo ishte njëra ndër arkitektet kryesore të gjenocidit serb ndaj shqiptarëve.
- Hipoteza 2. Kisha ortodokse serbe gjatë luftës së fundit në Kosovë bëri luftë fetare ndaj shqiptarëve myslimanë.

Bashkëpunimi i kishës serbe në masakra, gjenocid dhe etnocid mbi shqiptarët, nga viti 1912 e deri sot.

Kisha serbe është bashkëpunëtore me pushtetin serb në masakrimin, gjenocidin dhe etnocidin serb mbi shqiptarët, nga viti 1912 deri në ditët e sotme. Me bekimin e kishës, paramilitarët serbë, si dhe me mbështetjen e policisë dhe të ushtrisë, vranë dhe masakruan mijëra shqiptarë. Me strategjinë e tokave të djegura, së pari i plaçkitën dhe rrafshuan për tokë qindra fshatra në periudhën e ripushtimit të Kosovës në vitin 1918. Të dhënat flasin për 12 371 shqiptarë të vrarë dhe për 22 110 shqiptarë të arrestuar dhe të burgosur brenda një viti, nga ripushtimi i Kosovës në vitin 1918 deri në fillim të punës së Konferencës së Versajës në vitin 1919. Me bekimin e kishës, paramilitarët dhe policët serbë, në shtator të vitit 1920, i ngujuan në xhami dhe i dogjën për së gjalli rreth 1100 shqiptarë

të fshatit Pesoqan të Ohrit, me në krye imamin mulla Qamil Efendinë,. Në vitin 1920, në Jablanicë të Pejës e dogjën imamin me gjithë xhemat në xhami, ndërsa në vitin 1921, dogjën edhe imamin mulla Hasan Blakun në xhaminë e Istogut, së bashku me 98 xhematë. Po atë ditë, në Istog të Poshtëm, pushkatuan edhe 96 gra, fëmijë e pleq. Në datat 6-7 janar 1921, në Natën e Bozhiqeve ortodokse, militarët serbë me në krye vojvodën, priftin dhe komandantin policor dhe ushtarak, therën e dogjën në zjarr për së gjalli 1020 shqiptarë (nga këta 440 fëmijë e gra) në Prapshticë të Prishtinës.¹

Të nesërmen, në Ditën e Bozhiqeve, therën edhe 490 fëmijë, gra e pleq të Keqekolles e të fshatrave të tjera të Gollapit, si dhe anëtarët e familjes së mulla Ademit, para syve të tij. Një korrespondent danez informonte për 5000 shqiptarë të therur e të masakruar në rrethin e Prishtinës dhe për 3000 të tjerë në rrethin e Shkupit në fillim të vitit 1921. Ushtaraku i latë, Kaliqanin, në momentin kur duhet të largohej nga Mitrovica dhe nga Kosova, më 13-14 prill 1941, theri dhe pushkatoi 1300 ushtarë shqiptarë në njësitë ushtarake të Jugosllavisë. Këtë krim kurrë nuk u gjykoji kisha serbe, por e bekoji (masakra e Bihorit në Sanxhak) në Natën e Krishtlindjeve ortodokse të 5/6 janarit 1943. Në këtë masakër, brenda 3 deri 4 orëve, çetnikët të shoqëruar edhe nga shumë priftërinj masakruan me thikë-bajonetë dhe dogjën në zjarr 3 741 shqiptarë dhe boshnjakë myslimanë, gra, fëmijë, pleq dhe plagosën 634 të tjerë. Ata morën me vete 251 vajza dhe gra të reja dhe pas dhunimit shtazarak ua humbën edhe kufomat. Në këtë ditë u plaçkitën plotësisht dhe u dogjën 82 fshatra shqiptare dhe boshnjake. Ata vijuan me masakrime, dhe sipas Intelligence Service, numri i viktimave arriti në 6 625 persona.

Përfaqësuesit e komunave, si Biellopoj, Korita, Zoton e Rasovë, në deklaratën për qeverinë e Tiranës, më 27 janar 1943 saktësuam:

“Në emër të gjithë popullit, të gjithë popullit të Bihorit, kërkojmë me këmbëngulje t’i lidhemi mëmës Shqipëri, mbasi rrjedhim prej kësaj race dhe 90% e popullsisë së kësaj zone janë shqiptarë, ndryshe s’mbeti gjë tjetër për ne veç dhe pjesa që ka shpëtuar të merret dhe të mbytet. Pra, me 6 janar të vitit 1943 grupe të formacioneve çetnike serbe e malazeze, rreth 5000 sish (ushtarë, oficerë, nën komandën e vojvodës Pavle Gjurishiq) rrethuan katundet e Bihorit ku bënë një masakër të paparë. Në këtë masakër vranë e masakruan gra, pleq, fëmijë. Ata i masakruan në mënyrën më barbare më thika e

1 Prof.Dr. Muhamet Pirraku, “Jo katedrale”, f. 31-32.

bajoneta, ka pasur prerje të organeve të trupit për së gjalli dhe ka pasur të karbonizuar, ku disa viktimave iu kanë prerë gjymtyrët dhe disa organe për së gjalli dhe pastaj i kanë hedhur në zjarr”.²

Sulmi ishte bërë befas, dhe me pëlqimin e komandës italiane. Formacionet çetnike që e bënë këtë masakër u detyruan të tërhiqen nga viset e shkatërruara të Bihorit vetëm pas kundërvënies së 800 burrave të Tutinit dhe të komunave Delimegje e Suhadoll, menjëherë pasi ndodhi kjo masakër. Ndriçimin e kësaj masakre e mori përsipër zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve Botërore në qeverinë shqiptare, Iljaz Agushi, i cili formoi një komision për mbledhjen e të dhënave. Komisioni mbledhi katër arka më koka fëmijësh, duar e gjymtyrë të tjera, sy, veshë, hundë e gjinj të grave. Këto arka i dërguan në nënprefekturën e Tregovishtës (Rozhajë) e prej andej në Tiranë dhe pranë organeve më të larta të pushtetit okupues italian.³ Mirëpo qëndrimi mospërfillës e pro çetnik i komandës italiane shkaktoi pozicionimin e fuqishëm antiitalian në Kosovë, të cilin u munduan ta shfrytëzojnë edhe komunistët për synimet e tyre.

Në këtë periudhë për asgjësimin e shqiptarëve dhe ngjalljen e urrejtjes mes popujve joslavë krahas lëvizjeve çetnike, një rol shumë agresiv ka luajtur edhe kisha ortodokse serbe. Për klerikët serbë

“...shqiptarët ishin gjarpinjtë helmues që duheshin zhdukur, mbytur ose u duhej shtypur koka”.

Agjentët e Drazha Mihajoviçit paralajmëronin se

*“...çetnikët do ta çlirojnë Kosovën nga shqiptarët dhe të gjithë ata do t'i zhdukim, pa lënë njeri të gjallë”.*⁴

Kisha serbe kurrë nuk e denoncoi masakrën e Tivarit, të 1 prillit 1945, gjatë muajve mars-prill 1945, ku u vranë 8 000 djem kosovarë nga Brigada X malazeze, me urdhër të Ramiz Alisë, që i shoqëronte si komisar i Divizionit V. Përgjegjësi për masakrën e Tivarit kishte edhe udhëheqja komuniste e Kosovës me në krye nënkomandantin e Shtabit Operativ të Kosovës, Fadil Hoxha. Masakra e Tivarit është një ngjarje e rëndë, një njollë e zezë, të cilën historiografia shqiptare duhet ta konsiderojë të tillë dhe ta quajë tradhti kombëtare, vepër e bashkëpunëtorëve të politikës komuniste shqiptare me serbosllavët. Në këtë përballje të madhe, rol të madh antikombëtar luajtën Divizionet V dhe VI të Ushtrisë Nacionalçlirimtare (UNÇ) të Shqipërisë

2 Faton Mehmetaj, “Veprimtaria kriminale e dorës së zezë”, f. 303.

3 Faton Mehmetaj, “Veprimtaria kriminale e dorës së zezë”, f. 304.

4 Dr. Muhamet Shatri, “Kosova në Luftën e Dytë Botërore (1941-1945)”, Prishtinë, 1997, q. 55.

që u vunë nën urdhrat e Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë në UNÇ të Jugosllavisë dhe iu shërbenin okupatorëve serbo-malazez-maqedonas, për ripushtimin e Kosovës dhe të viseve shqiptare si dhe masakrave kundrejt popullit shqiptar e kundër luftërave të tij për liri. Kisha serbe ka pjesën e barrës edhe për shpërnguljen nga viset shqiptare dhe vënien në robërinë serbo-jugosllave të një milion shqiptarëve midis viteve 1912-1976.

Fituesit e luftës antifashiste në Jugosllavi (1944-1945) do ta shfrytëzonin konkluzionin e aleatëve në Konferencën e Teheranit se

“Për ata njerëz që kanë bashkëpunuar me fashizmin, është e drejtë e shteteve përkatëse ku ata jetojnë të deportohen ose të shfarosen, derisa të zgjasin operacionet e luftës”.

Në bazë të këtij parimi, qarqet politike serbe angazhuan një ekip që e udhëhoqte prifti Vllade Zeqeviq për t'i likuiduar hungarezët e Vojvodinës dhe shqiptarët në jug të Serbisë. Projekti gjendet në koleksionin e Vllada Zeqeviqit me titull “E drejta e deportimit 1945”, koleksioni Vllada Zeqeviq-AJ, Beograd”. Gjatë viteve 1918-1941, pushteti serb, në bashkëpunim me kishën ortodokse serbe përvetësuan nga shqiptarët 381 245 hektarë tokë pjellore.⁵ Atë tokë e kolonizuan me mjete të dhunshme 17 679 familje sllave, me qëllim të serbizimit të Kosovës. Priftërinjtë serbë në vitin 1935 iniciuan të ashtuquajturën “Konferencë Ndërmnistrore” në Beograd, sepse në vitin 1934 kishin arritur ta bindnin qeverinë t’i integronte të gjithë politikanët e shquar shqiptarë nga Jugosllavia. Si rezultat i kësaj konference ndërministrore, priftërinjtë filluan fushatën më të kobshme kundër popullit shqiptar në Klubin Kulturor Serb, në vitin 1937, dhe arritën që në vitin 1938 të publikonin konventën ndërmjet Jugosllavisë Mbretërore dhe Republikës së Turqisë për shpërnguljen e të gjithë shqiptarëve nga vatra e tyre deri në vitin 1944. Pas Luftës së Dytë Botërore, për shkak të terrorit edhe më të madh shtetëror dhe mbretëror dhe marrëveshjes së vitit 1938 me Turqinë, u larguan nga Kosova shumë shqiptarë. Këtë e konstaton me të drejtë dijetari Doc. Dr. Hfz. Hajredin Hoxha, në librin e tij “Barrierat e dialogut dhe shkaqet e dështimit të tij në kohën bashkëkohore”.⁶

Aleanca e Lidhjes së Komunistëve të Serbisë me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Serbisë dhe me Kishën Shënsaviane Serbe, e

5 Fejton, Prof. Dr. Hakif Bajrami, “Deportimi i shqiptarëve për në Turqi”, “Kosova sot”, e martë, 17 qershor 2014, f.35.

6 Hajredin Hoxha, “Barrierat e dialogut dhe shkaqet e dështimit të tij në kohën bashkëkohore”, “Furkan”, Shkup, 2013, f. 50.

ngritur mbi fantazmën e mitit serb të Kosovës pas Titos, është forca që rrënon bashkëjetesën dhe Jugosllavinë avnojiste. Në Memorandumin e SANU-it (1985), Kishës Shënsaviane Serbe iu caktua roli i forcës ringjallëse të frymës së mitit të Kosovës dhe të Serbisë qiellore. Fati i Kosovës mbeti çështje jetësore e të gjithë popullit serb, kurse prifti Dimitrije Bogdanoviq, në vitin 1986, do të thërrasë në emër të kishës serbe e të ardhmërisë kishtare e nacionale serbe të Kosovës: “*Miti serb për Kosovën duhet të jetë si ndërgjegje çlirimtare, dhe Germani, patriku serb, është mbështetësi shpirtëror i lëvizjes*”.

Roli i kishës serbe në manifestimin e 600- vjetorit të Betejës së Kosovës

Kisha serbe mori rolin më të rëndësishëm në përgatitjen e manifestimit të 600-vjetorit të Betejës së Kosovës në Gazimistan. Të gjitha institucionet në gjuhën shqipe u mbyllën nga pushteti serb në vitin 1990 dhe priftërinjtë nuk reagan kurrë. Politika e kishës ortodokse shkoi aq larg, saqë përmes pushtetit, e shndërruan Kosovën në një objekt industrial për ndërtimin e kishave të llojllojshme, që kishin qëllime politike, në çdo skutë të saj. Ky projekt industrial nisi me djegien e librave në gjuhën shqipe, si në kohën e inkuizicionit.⁷ Studiuesi serb, Millorad Tomaniq, në librin e tij “Kisha serbe në luftë dhe luftërat brenda saj”, thotë:

*“Gjatë viteve të 80-ta të shekullit të kaluar, nën tymin e dendur të duhanit dhe shisheve me raki, u hartuan planet për krijimin e Serbisë së Madhe. Gjatë viteve ’80 Kosova ishte tema qendrore, për të cilën më së shumti flitej në Serbi. Mirëpo për fat të keq, jo nga aspekti historik, por nga ai i miteve dhe misticizmi”.*⁸

E tërë ajo që kishte ndodhur në Bosnje për afro 4 vjet të agresionit serb atje, ishte hedhur dhe kamufluar nga të gjitha asociacionet serbe. Prijësit e kishës serbe kishin heshtur edhe për faktin që në Banjallukë, një qytet ku nuk ka pasur luftë, janë rrënuar 16 xhami dhe 5 tyrbe, si dhe sahat-kulla, ora e parë publike në Bosnjë e Hercegovinë. Në fund të vitit 1992 është vendosur eksploziv në xhaminë e Ferhadisë, dhe është dëmtuar xhamia më e bukur që ka pasur Bosnja si dhe tyrbja e Pashës aty në afërsi të xhamisë. Ky ishte vetëm fillimi, rrënimi i vërtetë do të fillonte më 9 prill 1993 me

7 Hakif Bajrami, “Institucionet në gjuhën shqipe u mbyllën më 1990 dhe ju, priftërinjtë nuk reaguat kurrë”!, Kosova sot, e dielë, 22 qershor 2014, f. 13.

8 Edukata Islame, Viti XXXIV nr. 75, Prishtinë, 2004, f. 263-264.

djegien e xhamisë në periferi të Banjallukës, pastaj u dogjën me radhë edhe dy xhami më të njohura, Ferhadia dhe Arnaudia, prej të cilave Ferhadia ishte bukuroshja e vërtetë dhe nën mbrojtjen e UNESCO-s. Që të dyja janë rënuar me minimin e tyre në mëngjesin e datës 7 maj të vitit 1993. E tërë kjo ka kaluar pa asnjë dënim të qartë nga ana zyrtare e KOS-it.⁹

Prej mbarimit të Luftës së Dytë Botërore dhe deri në fillim të viteve '80 -të, kisha ortodokse serbe ka qenë indiferente ndaj ndodhive shoqërore. Deklarimet publike dhe zyrtare të saj kanë qenë të rralla, kryesisht në raste kremtimesh në përvjetorë të rëndësishëm. Patriarku i atëhershëm serb, Germani, si dhe shumica e kryepeshkopëve, përpiqeshin të mos jepnin shkas për mosmarrëveshje e konflikte me pushtetin. Në gazetën “Pravoslavje” (Ortodoksia) gazetë kjo e patriarkanës serbe mund të gjesh edhe lavdërime të hapura ndaj ligjeve në fuqi të Jugosllavisë së Titos.¹⁰

Priftërinjtë serbë gjatë historisë, sidomos në shekullin XIX dhe XX, i shkelën parimet e shenjta fetare ortodokse. Në normën 65 të apostujve të shenjtë thuhet:

“Një klerik që në grindje e sipër qëllon dikë dhe e vret me një të rënë, atëherë ai shkarkohet pse u ngut...”.

Vallsamon shpjegon se saktësimi “me një të rënë”, do të thotë se kleriku shkarkohet edhe po kreu vrasje pa dashje, domethënë se “*kleriku i nënshtrohet shkarkimit pa marrë parasysh mënyrën e vrasjes së njeriut*”. Për klerikët, - thotë peshkopi Nikodim, - momentin kryesor këtu e përbën derdhja e gjakut të njeriut, pa marrë parasysh rrethanat dhe motivet që kanë shkaktuar gjakderdhje. Derdhja e gjakut të njeriut është në kundërshtim të plotë me shërbimin që kleriku kryen përgjithësisht. Në normën 7, të koncilin të katërt ekumenik thuhet :

“Urdhërojmë që ata që një herë u bënë klerikë ose iu kushtuan thirrjes së kallogjerit, të mos hyjnë as në shërbimin ushtarak, as në shërbim shekullar: atyre që veprojnë ndryshe e nuk kthehen të penduar, aty ku zgjodhën të ishin për hir të Zotit, u rëntë mbi kokë mallkimi!”

Le të përmendim edhe normën 5-të të Grigorit ku kërkohet:

“Ai që është përlyer me vrasje, qoftë edhe pa dashje, duke u bërë kështu i papastër për shkak të krimit, duhet të përjashtohet për forcë kanuni nga bekimi klerikal”.

9 Millorad Tomanic, “Kisha serbe në luftë dhe luftërat brenda saj”, f. 121-123.

10 Millorad Tomaniq, “Kisha serbe në luftë”, f. 97.

Pra, të paktën përsa iu përket klerikëve, kanunet e kishës ortodokse janë të prera: nuk lejohet kurrfarë mbajtje a përdorim armësh apo pjesëmarrje në luftë (në rolin e ushtarit). Ndërkaq, në historinë e kishës serbe ka shembuj të shumtë për këtë. Në vitin 1594, në Banat, kryengritjen e armatosur kundër osmanëve e udhëhoqi Teodori, peshkopi i Vershacit. Kundër osmanëve ka luftuar me armë në dorë edhe peshkopi tjetër, Pjetri Petroviq I.¹¹

Në fillim të shekullit XIX, Matej Nenadovic, bashkë me Karagjorgjin, ka qenë njëri prej udhëheqësve të kryengritjes së parë serbe. Në “memurat” e tij gjejmë emrat e shumë priftërinjve që gjatë gjithë luftës kanë qenë eprorë ushtarakë. *“Ata e dinin se një gjë e tillë nuk u shkonte, por kur flet arma, ligjet heshtin”*, thuhet në njërin nga numrat e gazetës “Pravoslavjes”. Nga mesi i të njëjtit shekull, Sava Decanoc, peshkop i Zhiqas, mori pjesë në luftimet kundër osmanëve për bashkimin e serbëve, si komandant i batalionit të Dezheves e Ibrit. Edhe në luftën e bërë nga mbreti Obrenovic kundër bullgarëve në vitin 1885, peshkopi Sava ka komanduar detashmentin e dytë të vullnetarëve. Në fund, ndonëse këtu nuk përfundon kurrsesi vargu i tyre, le të përmendim priftin Bogdan Zimonjic, udhëheqësin e kryengritjes së Nevesinjit të vitit 1875.¹² Në shtator të vitit 1991, afër Manastirit të Kamogovines në Kroaci, peshkopi i ardhshëm Filaret doli në fotografi me mitraloz në dorë. Fakt i njohur është se peshkopi Anifilohije, i cili ishte xhaxhi i bashkëshortes së ish-kryeministrit të Serbisë, Voislav Koshtunica, në vitin 1991, Manastirin e Cetinës e kishte shndërruar në kazermë për pjesëtarët e gardës vullnetare të Arkanit. Edhe Arkani nuk i kishte mbetur borxh kishës. Ai kishte thënë se komandant i tij suprem është patriarku Pavle. Kështu, pas aq shumë luftërave, torturimeve, masakrave, viktima të të cilave ishin njerëzit e pafajshëm të të gjitha nacionaliteteve dhe besimeve nga hapësirat e ish-Jugosllavisë, në të cilat roli i KOS-it ishte mëse i qartë, askush nuk mbajti përgjegjësi. Kjo kishë dhe dijetarët e saj, as sot e kësaj dite nuk gjejnë fuqi morale të distancohen dhe të kërkojnë falje nga popujt e tjerë për të gjitha ato të këqija që u kanë bërë.¹³

Politika serbe hartoi 32 programe, që nga viti 1844 e deri në vitin 1995, me qëllim të zhbërjes së popullit shqiptar. Gjysma e këtyre programeve kaluan nëpër duart e priftërinjve ose për më tepër ishin produkt i tyre.¹⁴ Politika serbe, e frymëzuar në fundamentalizmin ortodoks, duke

11 Millorad Tomaniq, “Kisha serbe në luftë”, f. 235-236.

12 Millorad Tomaniq, “Kisha serbe në luftë”, f. 236.

13 Edukata Islame, Viti XXXIV, nr. 75, Prishtinë, 2004, f. 268.

14 Prof. Dr. Hakif Bajrami, “Klarofashizmi serbomadh sërish në territorin e Kosovës”, Fejton, Kosova sot, e shtunë, 21 qershor 2014, f. 37.

mistifikuar realitetin, përpiqet ta realizojë synimin e vetëmashtrimit të vet, duk u bërë faktor determinues në shumicën e konflikteve shoqërore në hapësirat ballkanike. Në rrafshin historik, nga kjo politikë fundamentaliste panserbosllave, rezultoi që D.Paviq, A.Popoviqi, D. Tanoskoviq, M. Jevitiq, D. Kollajiq e shumë të tjerë punuan që islamin ta identifikojnë si diçka të huaj në tokën europiane.¹⁵

Në fillim të vitit 1993, disa qindra rusë luftuan në anën e serbëve. Gjithashtu, qarkullojnë të dhëna se armata ruse e furnizonte Serbinë. Pra, kjo lë të kuptohet se përkrahja që i bëhej Serbisë nga vendet ortodokse, ishte një perceptim i tyre se po bëhej luftë fetare në Ballkan dhe duhej të ndihmonin Serbisë ortodokse në dëm të katolikëve dhe myslimanëve.¹⁶ Slobodan Milloshoviqi erdhi në pushtet me ndihmën e UDB-së dhe kishës serbe, në vitin 1987. Në këtë kohë, qarqet kishtarë serbe përnjëherë do të promovonin parullën: *“Serbia në rrezik nga irredentizmi shqiptar”!* Kjo parullë ishte publike në vitet e mitingjeve serbe (1988-1990), të cilat i organizonte dhe i drejtonte makineria e Milloshoviqit. Në atë makineri, së pari ishte injektuar kisha serbe përmes lëkundjes së eshtrave të Llazarit në të gjitha territoret, të cilat me vonë i përfshiu lufta. Kjo do të thotë së kisha e përgatiti zjarrin, ndërsa Partia Socialiste e Serbisë dhe Akademia e Shkencave Serbe, e shtynë ushtrinë dhe policinë në luftë koloniale. Kështu, kisha serbe u shndërrua në institucion kadrovik misterioz për të gjithë politikën dhe hapësirën e ish-Jugosllavisë.¹⁷

Kisha ortodokse serbe e përfshirë në gjenocid ndaj myslimanëve të Ballkanit

Roli i kishës ortodokse serbe, në luftën e Bosnje-Hercegovinës dhe Kosovës ishte mjaft destruktiv. P.sh., në çastet kur nga Srebrenica dhe Zhepa po largoheshin rreth 100 000 boshnjakë prej dhunuesve të Karagjiqit, diku në periferi të frontit, prifti serb Llavrantije e bekonte me 14 korrik Ratko Mlladiqin. E thënë qartë, ishte menduar që Dr. Mihael Veninger (Ambasador i Austrisë në Beograd) ta dekoronte me Medalje të Artë një ditë me vonë, më 15 korrik, priftin Llavrantije në Beograd (Nasha Borba, 16, VII, 1995, f. 2). Sipas burimeve të sigurta, atë bekim dhe atë dekorim e përcillnin qarqet me të larta kishtarë serbe.¹⁸

15 Nexhat Ibrahim, “Islami si provokim global”, f. 139.

16 Nexhat Ibrahim, “Islami si provokim global2”, f.140.

17 Faton Mehmetaj, “Veprimtaria kriminale e dorës së zezë”, f. 365-366.

18 Dr. Hakif Bajrami, “Politika e lufta e drejtë shqiptare përballë neofashizmit serb (1989-1999)”.

Roli i kishës serbe gjatë luftës së fundit në Kosovë

Në mbledhjen e jashtëzakonshme të kuvendit të shenjtë arkeierik, në janar të vitit 1991, u vendos që asnjë vendim politik që ka të bëjë me serbët të mos merret pa prezencën e kishës. I njëjti kuvend kishtar, në janar të vitit 1992, solli vendimin që të mos i pranojë kufijtë ndërmjet Republikave Jugosllave.

Gjatë luftërave në Jugosllavi në vitet 90-të, shumë vlladika dhe priftërinj të kishës ortodokse serbe haptazi janë vënë në shërbim të ushtrisë serbe. Në atë kohë arqimandriti Fillaret haptazi ftonte në luftë përmes mediave dhe shkonte nëpër vatra të luftës duke i trimëruar vullnetarët serbë. Për kishën ortodokse serbe ky ishte shkak që më vonë atë ta ngrinin në gradën e ipeshkvit të Eparkisë së Milesheves.¹⁹ Kisha ortodokse serbe, e cila kishte bërë fushatë aktive për krijimin e Serbisë së Madhe, kërkoi në vazhdimësi unifikim të botës ortodokse kundër myslimanëve në Ballkan.²⁰

Duhet cekur se procesin e serbizimit të Kosovës shteti serb e bënte në shumë fusha në Kosovë, sidomos në procesin e kolonizimit të Kosovës me banorë serbo-malazez, proces që u intensifikua nga vitet 1990-1997.²¹ Po në këto vite, kisha ortodokse serbe, në vende të ndryshme të Kosovës ndërtoi 67 objekte fetare serbe, edhe pse në ato vende nuk kanë ekzistuar kurrë më parë objekte të tilla, pra të gjitha këto kisha ishin politike.

Për fat të keq, inkriminimi i KOS-it gjatë luftës në vitet 1998-1999, mori përmasa të mëdha, saqë kryqi si simboli me i lartë i kërkim -faljes tek të krishterët, nga disa policë, ushtarë dhe militarë serbë u kthye në një simbol për keqtrajtimin dhe tmerrin e të rinjve shqiptarë të besimit islam, duke vizatuar me thikë kryqin në pjesë të ndryshme të trupave, te të rinjtë shqiptarë. Ajo që është më tragjike është se kisha ortodokse serbe kurrë nuk e ngriti zërin për t`i denoncuar krimet kundër shqiptarëve.

Serbët, në çdo fshat që depërtonin, së pari digjnin xhamitë e fshatrave dhe vizatonin kryqin serb të rrethuar me katër c, që simbolizonte që vetëm bashkimi e shpëtonte Serbinë apo Serbinë e Madhe.²² Vlen për t`u

Prishtinë, 2006, f. 138.

19 Adem Zalihiq, "Babai i urrejtjes serbe ndaj boshnjakëve, shqiptarëve dhe Islamit", Sarajevë, 2017, f. 29-30.

20 Branimir Anzuloviç, "Serbia hyjnore prej mitit në gjenocid", Koha, Prishtinë, nëntor, 2017, f.200-201.

21 Fetnete Ramosaj, "Kundër harresës, Instituti për hulumtimin e krimeve të luftës, Prishtinë, 2017, f. 57.

22 Sherif Delvina, "Kosova një mit serb apo realitet historik shqiptar", Tiranë, Euroilindja, 2000, f.130-131.

theksuar deklarata e patriarkut Pavel, i cili në muajin mars në vitin 1999, me rastin e masakrave të shqiptarëve nga forcat serbe në Kosovë, midis të tjerave deklaroi:

“Ungjilli thotë ka luftëra të drejta dhe të padrejta. Mbrojtja e Kosovës është luftë e drejtë, prandaj me çdo mjet dhe në çdo kohë duhet të dëbohen pushtuesit shqiptarë”.

Po ashtu, kriminelin serb, me nofkën “Arkan” kishte thënë, se ne jemi duke luftuar për fenë tonë, kishën ortodokse serbe, për krijimin e një shteti të madh e të bashkuar serb.²³ Zhelko Razhnatović u bë figurë politike vetëm atëherë kur më 11 tetor 1990, me disa shokë dhe të njohur, kryesisht huliganë të Beogradit themeluan në manastirin ortodoks “Pokajnica” gardën vullnetare serbe, duke u bërë vetë komandant i saj.²⁴ Kryemafiozi Arkan, në kulmin e karrierës së tij, me uniformën zyrtare të gjeneralit u dekorua me kryqin e madh të patriarkanës serbe, për shërbesë të çmuar në dobi të ortodoksisë.

Për rolin tejet destruktiv të kishës ortodokse serbe gjatë luftës në Kosovë dëshmon një numër i madh i dokumenteve. Disa prej tyre do t’i citoja siç janë: Dokumenti i 25 tetorit i vitit 1998, i nënshkruar nga kisha ortodokse serbe dhe lëvizja e rezistencës serbe për Kosovën, që bënin thirrje për popullin serb për mosnjohjen të asnjë marrëveshjeje me ndërkombëtarët dhe që në Kosovë, sipas tyre, duhet të veprojë fuqishëm policia dhe ushtria serbe kundër popullit të Kosovës.

Dokumenti numër 371, i datës 29 tetor i vitit 1998, i nënshkruar nga episkopi Rashk-Prizren thërret për luftë kundër shqiptarëve. Ndërkaq, dokumenti nr.38/3625, i datës 29.05.1999, tregon se organizatat ekstremiste ortodokse serbe ishin të sajura nga shteti dhe të financuara nga shteti.

Është e rëndësishme të theksoj se kisha ortodokse serbe është njëri ndër katër faktorët më destruktivë të çështjes së Kosovës gjatë tërë historisë, së bashku me politikën serbe, akademinë serbe dhe organizatat ekstremiste ortodokse serbe.

Në përfundim mund të themi se:

Kisha ortodokse serbe, gjatë gjithë historisë, ishte në shërbim të politikës antishqiptare në Kosovë. Prandaj ajo kishte në programin e saj ndërtimin e shumë kishave në fshatra dhe në qytete të Kosovës për t’i serbizuar këto vise.

23 Norbert Maoes- Niedeck, “Mafia e Ballkanit”, Asdreni, Shkup, 2005, f.37.

24 Pano Halko, “Greqia dhe Shqipëria siç nuk duhet të jenë”, Alsar, Tiranë, 2019, f.75.

Me të njëjtat pretendime, kisha ortodokse ka uzurpuar në qendër të Prishtinës trojet e Universitetit (vendi ku është ndërtuar kisha ortodokse).

Këto kisha, kanë karakter politik, tendencioz, dhe nuk u ndërtuann për nevojat e besimtarëve ortodoksë, as për nder të Perëndisë, por për nevojat e politikës antishqiptare, ekspansioniste, shoviniste serbe, për nder të udhëheqjes së saj politike.

Roli i kishës serbe gjatë historisë ka qenë shumë destruktiv në shkatërrimin e identitetit kulturor, etnik dhe fetar të shqiptarëve në Ballkan.

Nga kjo që u paraqit më lart, mund të nxjerrim përfundimin se kisha ortodokse serbe nuk është kishë nacionale, por nacionaliste. Ajo mbetet më shumë organizatë politike sesa institucion fetar, gjithnjë në shërbim të idesë së Serbisë së Madhe, në shërbim të politikës imperialiste, duke shkelur edhe vetë normat e moralit fetar në lidhje me respektimin e të drejtave të besimeve tjera.

Bibliografia

1. Tomaniç, Millorad. “Kisha serbe në luftë dhe luftërat brenda saj”, “Camaj-Pipaj”, Shkodër, 2006.
2. Rizaj, Skënder. “E drejta historike shqiptare për vetëvendosje”, Prishtinë, 2005.
3. Instituti Albanologjik, “Gjurmet albanologjike”, Prishtinë, 1996.
4. “Edukata Islame”, Viti XLI, Nr. 102, Prishtinë, 2013.
5. Spahiu, Nexhmedin. “Foshnjëria e kombit kosovar”, Prishtinë, 2014.
6. Piraku, Muhamet. “Jo katedrale në emër të shqiptarisë së imagjinuar”, (botimi i dytë), Prishtinë, 2003.
7. Cana, Zekrija. “Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar” (dokumente), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1996.
8. Zenelaj, Eqrem. “Çështja shqiptare nga këndvështrimi i diplomacisë dhe gjeopolitikës së Austro-Hungarisë (1699-1918)”, shtëpia botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 2010.
9. Mehmetaj, Faton. “Veprimtaria kriminale e dorës së zezë”, Botoi “Anatema”, Prishtinë, 2004.
10. Shatri, Muhamet. “Kosova në Luftën e Dytë Botërore (1941-1945)”, Prishtinë, 1997.
11. Hoxha, Hajredin. “Barrierat e dialogut dhe shkaqet e dështimit të tij në kohë bashkëkohore”, botoi “Furkan”, Shkup, 2013.

12. “Edukata islame”, viti XXXIV, Nr.75, Prishtinë, 2014.
13. Ibrahim, Nexhat. “Islami si provokim global”, botoi “Logos, A”, Shkup, 2006.
14. Mehmetaj, Faton. “Kosova dhe sfidat e sigurisë”, Prishtinë, 2009.
15. Bajrami, Hakif. “Politika e lufta e drejtë shqiptare përballë neofashizmit serb (1989-1999)”, Prishtinë, 2006.
16. Bajrami, Hakif. “Priftërinjtë e Serbisë nxitës të klerovashizmit në Ballkan”, Kosova sot, e premte, 13 qershor 2014.
17. Dr. Hakif Bajrami. “Depërtimi i shqiptarëve në Turqi”, Kosova sot, e martë, 17 qershor, 2014.
18. Dr. Hakif Bajrami. “Institucionet në gjuhën shqipe u mbyllën më 1990 dhe ju priftërinj nuk reaguat kurrë”, Kosova sot, e dielë, 22 qershor 2014.
19. Dr. Hakif Bajrami. “Klerofashizmi serbomadh në territorin e Kosovës”, Kosova sot, e shtunë, 21 qershor 2014.
20. Zalihiq Adem. “Babai i urrejtjes serbe ndaj boshnjakëve, shqiptarëve dhe Islamit”, Sarajevë, 2017.
21. Ramosaj Fetnete, “Kundër harresës”, Instituti për hulumtimin e krimeve të luftës, Prishtinë, 2017.
22. Delvina Sherif. “Kosova një mit serb apo një realitet historik shqiptar”, Tiranë, Eurolindja, 2000.
23. Mehmetaj Faton. “Veprimtaria e shërbimeve sekrete ruse në shtetet e Ballkanit”. ISGJS –Prishtinë, 2018.